



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENE  
KËSHILLI BASHKIAK



Nr.7 prot

Tepelenë, më 26 06.2026

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot më 26.06.2026, në orën 10:00, në Pallatit të Kulturës, Tepelenë (kati i dytë), në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Përfaqësues të administratës së Bashkisë Tepelenë: **znj. Julinda Karteri, z. Gëzim Shehu, Jetnor Haska**, Përgjegjës Ujësjiellës Tepelenë, si dhe përfaqësues të drejtorive që kishin përgatitur materialet për shqyrtim.

Në momentin e hapjes së mbledhjes ishin të pranishëm këshilltarët: **Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj**.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z. Arben Gumeni**, pasi konstatoi praninë e kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, deklaroi të hapur mbledhjen dhe paraqiti për shqyrtim dhe miratim rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 28.05.2026.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Maj 2026."
4. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Maj 2026."
5. **Projektvendim:** "Për transferimin e aseteve të financuara nga AKUK dhe të realizuara nga Bashkia Tepelenë."
6. **Projektvendim:** "Për miratimin e planit të integritetit 2026-2028 Bashkia Tepelenë."
7. **Projektvendim:** "Për miratim të kërkesës, për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pronë e Bashkisë Tepelenë."
8. **Projektvendim:** "Për miratimin e masave administrative dhe përcaktimin e kundërvajtjeve administrative në territorin e Bashkisë Tepelenë."

9. **Projektvendim:** "Për miratimin e tarifave, rregullave të administrimit dhe përcaktimin e hapësirave të parkimit për mjetet publike dhe private në territorin e Bashkisë Tepelenë."
10. **Projektvendim:** "Për miratimin e një shtese në kontratat e përdorimit të kullotave, lidhur me mirëmbajtjen e shtigjeve turistike dhe garantimin e sigurisë së vizitorëve."
11. **Projektvendim:** "Për miratimin e standardeve dhe vendosjen e sinjalistikës turistike për shtigjet, monumentet e kulturës dhe atraksionet turistike në territorin e Bashkisë Tepelenë."
12. **Projektvendim:** "Për miratimin e Manualit të Arredimit Urban për Kalanë e Tepelenës, zonën muzeale dhe fshatrat me prioritet zhvillimi turistik në territorin e Bashkisë Tepelenë."
13. Informacion mbi Raportin e Performancës së Bashkisë Tepelenë për vitin 2025.
14. Informacion mbi problematikat dhe masat e marra nga Sektori i MZSH- së për parandalimin e zjarreve për periudhën e nxehtë të verës.
15. Çështje të tjera.
16. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Z.Arben Gumeni; Pershendetje përpara se të kalojmë në rendin e ditës, dua t'ju informoj se, pas shkresës që i dërguam Administratorit të Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Gjirokastër për pjesëmarrje në këtë mbledhje, kemi marrë një përgjigje me anë të së cilës njoftohemi se ai nuk mund të jetë i pranishëm për shkak të një angazhimi tjetër, drejtori duhej të ishte i pranishëm në këtë mbledhje për të dhënë sqarimet e kërkuara. Për këtë arsye, propozoj që javën e ardhshme të zhvillojmë një mbledhje jashtë radhe ne lidhje me ceshtjet e kërkuara, nqs nuk vjen në mbledhjen jashte radhe ti kërkojme Kryetarit të Bashkise heqjen e aksioneve nga kjo shoqeri. Do t'i dërgojmë një shkresë zyrtare Administratorit të Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Gjirokastër për të marrë pjesë në mbledhjen ashte radhe, nëse edhe kësaj here nuk paraqitet, Këshilli Bashkiak do t'u drejtohet me shkresë institucioneve më të larta për të kërkuar ndërhyrjen e tyre.

Çfarë date propozoni të zhvillohet mbledhja jashte radhe? A jeni dakord që ajo të mbahet javën e ardhshme?

**Anëtarët e Këshillit:**Dakord.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** Atëherë mbledhja jashtë radhe do të zhvillohet javën e ardhshme. Data dhe ora e saktë do t'ju njoftohen

**Z. Dino:** Pse qytetarët e Tepelenës paguajnë tarifën më të lartë të ujit krahasuar me bashkitë e tjera të qarkut? Pse riparimi i defekteve vonohet kaq shumë? Ka shumë ankesa nga qytetarët lidhur me këtë problematikë.

**Z. Jetnor Haska:** Tarifa e ujit për qytetet në të gjithë qarkun është 500 lekë, ndërsa për zonat rurale situata është e ndryshme. Në bashkitë Përmet, Dropull dhe Gjirokastër, tarifa për fshatrat është 200 lekë. Për këtë çështje i kam drejtuar një shkresë Bashkisë.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** Kalojmë në rendin e ditës. A jeni dakord me rendin e ditës?

**Z. Ditar:** A do të diskutohen sot të gjitha pikat e rendit të ditës?

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** Jo, pikat 5, 8, 9, 10, 11, 12 nuk do të shqyrtohen në mbledhjen e sotme dhe hiqen nga rendi i ditës.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraç, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: S'ka

Pika e dytë e rendit të ditës: Miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 28.05.2026.

Kryetari i Këshillit; Ka ndonje pyetje në lidhje me procesverbaline mbledhjes së kaluar.

Hedhim në votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Votimi i hapur

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraç, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela dhe Latif Kaçaj.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: S'ka

**Projektvendim:** Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Maj 2026.

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare komisionit ekonomisë: Ky material nuk ka ndryshime, ndihme ekonomike me fond 6 %, për muajin Maj përfitojnë 10 familje me fond 43858 lekë, ftoj keshilltaret ta votojnë .

Kryetari i Këshillit; Ka pyetje? jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraç, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: S'ka

Pika e katërt e rendit të ditës: “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Maj 2024”

**Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat:**

Për muajin maj janë trajtuar 87 familje me ndihmë ekonomike. Krahasuar me muajin e kaluar, ka ulje e numrit të përfituesve me 5 familje, të cilat kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike si rezultat i përfshirjes në programet e punësimit. Relacioni shoqëruar ju është vënë në dispozicion. Ju ftoj ta miratojmë projektaktin.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** A ka pyetje ose diskutime? jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraç, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: S'ka .

**Projektvendim:** "Për miratimin e planit të integritetit 2026-2028 Bashkia Tepelenë."

**Fjalën e mori znj. Julinda Karteri, Drejtore Juridike:** Jani njohur me materialin e shpërndarë. Unë do të paraqes një përmbledhje të punës së zhvilluar nga grupi i punës i ngritur nga Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, për hartimin e Planit të Integritetit.

## **QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT**

Integriteti institucional është i lidhur ngushtë me besimin e publikut tek qeverisja duke garantuar transparencë, komunikim të hapur, llogaridhënie dhe zbatim të procedurave ligjore. Shkelja e integritetit institucional mund të ketë pasoja që lidhen me cenimin e interesit publik, dëmtimin e besimit të qytetarëve tek administrata publike, si edhe cënimin e imazhit të saj. Prandaj, forcimi i integritetit institucional është një synim i rëndësishëm për vetëqeverisjen vendore, veprimtaria e së cilës ka impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe komuniteteve. Në këtë kuadër, bashkia Tepelenë ka ndërmarrë nismën për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2026-2028, me qëllim evidentimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin e një plani masash për minimizimin e tyre në një plan afatmesëm.

Qëllimi i këtij plani është të krijojë dhe konsolidojë një administratë vendore që i kundërvihet korrupsionit, transparente, inovative dhe e përgjegjshme për qytetarët, ku Këshilli Bashkiak (KB), administrata dhe shoqëria civile bashkëqeverisin në mënyrë etike dhe të krijojmë një administratë vendore që parandalon korrupsionin.

Hartimi i Planit u realizua nga një Grup Pune i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë i përbërë nga përfaqësues të administratës, të cilët u asistuan nga ekspertët e AMVV. Procesi zgjati nga Shkurt- Prill 2026.

Hartimi i Planit të kaloi në fazat e mëposhtme:

### **Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore**

Plani i Integritetit funksionon si një instrument vetëvlerësimi për institucionin dhe si një strategji tërësore masash të dizajnuara për të adresuar sfidat specifike që lidhen me integritetin dhe etikën. Kjo nismë është e rëndësishme, pasi ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të dëmtojnë reputacionin e institucioneve publike.

Hapi i parë në procesin e krijimit të këtij plani ishte ngritja e një grupi pune, me përfaqësues nga administrata e bashkisë. Ky grup ka në përbërjen e tij, punonjës nga fushat kryesore të funksioneve administrative dhe luan një rol kyç në analizimin dhe vlerësimin e sfidave me të cilat përballlet institucioni.

### **Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit**

Grupi i punës shqyrtoi kornizën rregullatore, strategjike si dhe dokumente të ndryshme operative të bashkisë. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë. Me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore, në këtë fazë u zhvilluan 7 grupe të fokusuara diskutimi me punonjësit e bashkisë sipas fushave të kompetencave të përgjithshme dhe funksionale. Në këtë fazë gjithashtu, punonjësit e administratës plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Ky pyetësor u plotësua nga 33, përfaqësues të administratës së bashkisë.

### **Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit**

Grupi i Punës në bashkëpunim me ekspertët, specialistët dhe punonjës kyç me eksperiencë, bëri vlerësimin e risqeve të integritetit. Risqet e identifikuara u vlerësuan dhe u bazuan në:

Tre dimensionet e ndërruar:

Probabiliteti i shfaqjes së ngjarjes;

Impakti mbi integritetin institucional dhe besimin publik;

Efikasiteti i kontrolleve ekzistuese.

Bazuar në mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin e tyre, risqet u kategorizuan në nivele të ndryshme (i lartë, mesatar, i ulët) dhe u renditën sipas prioritetit.

### **Faza 4: Plani i masave për menaxhimin e integritetit**

Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit është një hap i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimin të stafit mbi problematikat që hasen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Nga analiza e të dhënave rezultoi se Bashkia Tepelenë ka nevojë për plotësimin e kuadrit rregullator për etikën dhe integritetin, në kapacitete njerëzore, financiare dhe teknike për zbatimin e objektivave të saj strategjik që sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve, por edhe faktorë të tjerë risqesh që lidhen me ofrimin e shërbimeve apo kryerjen e funksioneve të veta ndaj qytetarëve. Në përfundim të fazës së renditjes së risqeve sipas prioritetit, Grupi i Punës diskutoi mbi hartimin e një plani veprimi me masa konkrete për adresimin e risqeve të evidentuara. Ky Plan Veprimi përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuara sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse.

Tre janë qëllimet kryesore të identifikuara për planin e integritetit të bashkisë tepelene për vitin 2026-2028.

1. Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;

Kuadri i brendshëm rregullator është thelbësor për të siguruar një qeverisje me integritet, pasi krijon bazat për organizimin dhe funksionimin etik të veprimtarisë së bashkisë. Ky përmirësim përfshin:

- Përditësimin e Kodit të Etikës, duke përfshirë në të rregulla për pranimin e dhuratave dhe regjistrin përkatës, për veprimtaritë e jashtme, për donacionet për lobistë etj
- Hartimin e strategjive dhe zbatimin e të gjitha procedurave ligjore që lidhen me etikën dhe integritetin institucional.

2. Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;

Forcimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion do të sigurojë kapacitete dhe aftësi të nevojshme për të zbatuar dhe konsoliduar mekanizmat garantues të integritetit në institucion. Ky objektivi synon rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve në përputhje me performancën në punë.

3. Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike, si dhe menaxhimi i integritetit në fusha të veçanta të bashkisë.

Një nga elementet thelbësore të qeverisjes demokratike është transparenca dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje. Megjithatë bashkia Tepelenë ka një faqe zyrtare të mirë në këtë ajo ka nevojë të përforcojë nivein e transparencës duke e bërë atë proaktive. Kjo siguron që publiku dhe grupet e interesit të informohen për mënyrën se si bashkia i shërben interesit të përgjithshëm të komunitetit, duke krijuar mundësi për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë përmes proceseve të konsultimit.

Plani i integritetit i rendesishëm dhe zbatimi i tij në bashkinë tepelene do të forconte punëtonet në shërbim të qytetarëve.

Kryetari i keshillit; Ka pyetje? jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: S'ka

**Projektvendim:** "Për miratim të kërkesës, për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pronë e Bashkisë Tepelenë."

Fjalën e mori z. Gezim Shehu Drejtor i zhvillimit rural; Sipas materiali të paraqitur bashkëlidhur është dhe shkresa protokolluar në Bashkinë Tepelenë me numër 1004 prot. datë 20.05.2026, për

“Kërkesë për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë”, si dhe Vendimi nr.7 datë 24.03.1998 të KRRT Tepelenë për miratim sheshe ndertimi te perhershme ne qytetin tepelene

Qëllimi kryesor i këtij akti është dhënia e dakordësisë për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Tepelenë, në mënyrë që Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM) të vijojë fazat e mëtejshme të këtij projekti, përfshirë përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe administrative. Kjo procedurë është në përputhje me ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe dokuemntat e planifikimit në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane. Ky vendim do të bëjë të mundur vazhdimin e projekteve për rehabilitimin e këtij venddepozitimi njëkohësisht me projektin për ndërtimin e stacionit të transferimit, nga i cili pika fundore e depozitimit të mbetjeve urbane do të jetë “landfilli” (venddepozitimi) Bajkaj në Delvinë.

**Z. Ditar:** Ku ndodhet vendi ku parashikohet të zbatohet ky projekt?

**Z. Gëzim:** Vendi i parashikuar ndodhet në kufirin me Bashkinë Memaliaj. Projekti do të jetë i përbashkët për të dy bashkitë. Venddepozitimi ekzistues do të mbyllet dhe më pas do t'i nënshtrohet procesit të rehabilitimit.

**Znj. Julinda Karteri:** Ky është një projekt i Qeverisë Shqiptare. Në këtë kuadër është parashikuar edhe projekti i financuar nga Banka Botërore, i cili krijon mundësinë për ngritjen e stacioneve të transferimit të mbetjeve, si dhe për mbylljen dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese.

**Z. Ditar:** Edhe Bashkia Memaliaj duhet të japë dakordësinë e saj.

**Z. Vladimir Bakiaj:** Në çfarë faze ndodhet projekti?

**Z. Gëzim:** Projektet teknike ende nuk janë hartuar. Aktualisht po punohet në fazën përgatitore. Pa miratimin e Këshillit Bashkiak, agjencia përkatëse nuk mund të vijojë me hartimin e projektit. Relacioni teknik do të përgatitet pasi Këshilli Bashkiak të japë dakordësinë.

**Znj. Julinda Karteri:** Ky projekt krijon mundësinë për mbylljen dhe rehabilitimin e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve, duke përmirësuar menaxhimin e tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** Kryetari i keshillit; Ka pyetje? jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj. Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: S'ka

Informacion mbi Raportin e Performancës së Bashkisë Tepelenë për vitin 2025.

Fjalën e mori znj. Xhulia Meta, Koordinatore e Njësisë së Performancës pranë Bashkisë Tepelenë, e cila paraqiti Raportin e Performancës së Bashkisë Tepelenë për vitin 2025, sipas materialit të bashkëlidhur. Raporti është hartuar në bashkëpunim me grupin e punës të ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, si edhe me drejtoritë e Bashkisë Tepelenë.

**Znj. Julinda Karteri:** Në lidhje me Raportin e Performancës, është angazhuar i gjithë stafi i Bashkisë, ku çdo drejtori ka kontribuar me të dhënat përkatëse në fushën e saj të përgjegjësisë. Të gjithë janë të gatshëm të japin shpjegime dhe sqarime për çdo pyetje që mund të keni lidhur me përmbajtjen e raportit.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni:** A ka pyetje ose diskutime lidhur me Raportin e Performancës?

**Z. Latif Kaçaj:** Në raport thuhet se transfertat nga pushteti qendror përbëjnë 85%. A mund të na jepni një sqarim lidhur me këtë tregues?

**Z. Gazmend Groshi:** Transferta e pakushtëzuar akordohet nga Qeveria Qendrore, ndërsa pjesa tjetër, rreth 15%, përbëhet nga të ardhurat që bashkia siguron nga burimet e veta.

**Z. Gazmend Groshi:** Lidhur me realizimin e buxhetit për vitin 2025, në pjesën e të ardhurave, buxheti është realizuar në masën 100%. Për pjesën e shpenzimeve nuk disponoj në këtë moment informacion të detajuar. Për të përmirësuar realizimin e të ardhurave vendore, Bashkia ka hartuar një plan veprimi për administrimin e tatim-paguesve, i cili parashikon rishikimin e tarifave bazë, përmirësimin e punës së sektorit të tatim-taksave, si dhe angazhimin maksimal të kryetarëve të fshatrave dhe administratorëve të njësive administrative për realizimin e planit të të ardhurave.

**Znj. Matilda Çela:** Sa ka ndikuar performanca e Bashkisë në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit dhe në rritjen e shërbimeve të ofruara për qytetarët?

Sa përqind e buxhetit është realizuar gjatë periudhës së raportimit, dhe cilët zëra buxhetorë kanë pasur nivelin më të ulët të realizimit?

Në cilat fusha Bashkia nuk ka arritur të përmbushë objektivat e planifikuara dhe cilat janë arsyet që kanë ndikuar në mosrealizimin e tyre?

Cilat projekte të planifikuara nuk janë realizuar deri në këtë fazë dhe kur parashikohet të përfundojë zbatimi i tyre?

A ka pasur rekomandime nga auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm? Nëse po, në çfarë niveli janë zbatuar këto rekomandime nga administrata e Bashkisë?

**Znj. Julinda Karteri:** Në përgjigje të pyetjes së parë, të gjitha të dhënat e paraqitura në Raportin e Performancës pasqyrojnë përmirësimin e shërbimeve të ofruara ndaj komunitetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së Bashkisë, janë shënuar arritje të rëndësishme, për të cilat ndihemi krenarë, veçanërisht në përmirësimin e shërbimeve publike, rritjen e cilësisë së infrastrukturës rrugore, zhvillimin e jetës kulturore dhe sportive, si dhe zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Tepelenë. Të gjitha këto ndërhyrje kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë.

Tek raporti i performancës u paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha këto tregues dhe rezultatet e arritura në secilën fushë, nga koordinatori gjatë prezantimit.

**Z. Albert Kasi, Koordinator i Projektit BF:** Është bërë një punë shumë e mirë nga grupi i punës i ngritur për hartimin e Raportit të Performancës. Ky proces është realizuar nga grupi i punës duke mbledhur të dhënat nga të gjitha drejtoritë përkatëse.

**Znj. Matilda Çela:** A disponon Bashkia një strukturë të auditimit të brendshëm?

**Znj. Julinda Karteri:** Aktualisht, dy specialistët e ngarkuar me funksionin e auditimit të brendshëm janë në proces certifikimi pranë Ministrisë së Financave dhe, për këtë arsye, nuk janë të pranishëm në mbledhjen e sotme.

Gjithashtu, Bashkia është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për një periudhë trevjeçare. Aktualisht jemi në pritje të raportit përfundimtar të auditimit. Pasi raporti të depozitohet zyrtarisht, ai do t'i paraqitet dhe do të diskutohet në Këshillin Bashkiak, së bashku me masat që do të merren për zbatimin e rekomandimeve.

**Znj. Matilda Çela:** Cilat janë projektet e planifikuara që nuk janë realizuar gjatë vitit 2025?

**Znj. Julinda Karteri:** Gjatë vitit 2025, Bashkia ka aplikuar për një numër të konsiderueshëm projektesh. Një prej tyre është projekti për digën e Turanit, i cili është miratuar gjatë këtij viti dhe aktualisht ndodhet në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderit për zbatimin e tij.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Bashkia ka aplikuar në disa thirrje për financim, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës rrugore, rehabilitimin e banesave dhe investime të tjera në funksion të zhvillimit vendor. Një pjesë e këtyre thirrjeve vijojnë edhe gjatë vitit 2026. Në fund të vitit 2025 është nënshkruar kontrata për

projektin e sistemit të ndriçimit rrugor në fshatrat Nivicë dhe Salari. Po ashtu, në fushën e shërbimeve sociale janë ndërmarrë projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për familjet dhe komunitetet në nevojë.

**Znj. Matilda Çela:** Si matet niveli i kënaqësisë së qytetarëve ndaj shërbimeve të ofruara nga Bashkia dhe cilat janë prioritetet kryesore të performancës për vitin e ardhshëm?

**Znj. Julinda Karteri:** Matja e kënaqësisë së qytetarëve për shërbimet e Bashkisë realizohet nëpërmjet dëgjësave publike, procesit të llogaridhënies që administrata zhvillon përpara Këshillit Bashkiak, si dhe përmes pyetësorëve dhe anketave që kryhen nga drejtoritë përkatëse. Nga këto vlerësime kemi marrë rezultate pozitive, megjithëse ka pasur edhe kritika dhe sugjerime, të cilat i vlerësojmë dhe i marrim në konsideratë për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve.

Gjatë vitit 2026 synojmë të konsolidojmë më tej performancën e Bashkisë, pasi janë miratuar ose janë në proces miratimi disa dokumente strategjike të rëndësishme, si Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, Plani për Arsimin Parashkollor dhe Plani i Mbarështimit të Pyjeve. Prioriteti ynë për vitin 2026 është zbatimi i këtyre planeve dhe arritja e objektivave të përcaktuara në to.

**Znj. Matilda Çela:** Për matjen e kënaqësisë së qytetarëve do të sugjeroja përdorimin e pyetësorëve online, të cilët mund të plotësohen nga qytetarët dhe të shërbejnë si një mjet shtesë për vlerësimin e shërbimeve.

**Znj. Julinda Karteri:** Për dëgjësë publike ne realizojmë anketime, të cilat na ndihmojnë të vlerësojmë perceptimin e qytetarëve për shërbimet e ofruara.

**Z. Albert Kasi:** Përveç administratës, edhe Këshilli Bashkiak mund të zhvillojë anketime të pavarura, në kuadër të rolit të tij monitorues dhe kontrollues ndaj veprimtarisë së Bashkisë.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni;** A ka pyetje të tjera?

**Z. Vladimir Bakiaj:** Në raportin e performancës, të vitit 2021-2025 përse nuk janë përfshirë sektori i ujësjellësit dhe ai i shëndetësisë?

**Znj. Julinda Karteri:** Raporti i paraqitur është Raporti i Performancës për vitin 2025.

Xhulla; Raporti i Performancës u është përcjellë të gjithë këshilltarëve edhe në adresat e tyre elektronike.

**Z. Vladimir Bakiaj:** Në lidhje me performancën në fushën e infrastrukturës rrugore, dua të ngre shqetësimin për mungesën e sinjalistikës në segmentet e rrugës nacionale që kalojnë në territorin e Bashkisë.

**Znj. Julinda Karteri:** Për sa i përket infrastrukturës rrugore, Bashkia është përgjegjëse vetëm për rrjetin rrugor që është në pronësi dhe administrim të saj. Infrastrukturën rrugore kombëtare e administrojnë dhe e mirëmban autoriteti përgjegjës, përkatësisht Autoriteti Rrugor Shqiptar. Për këtë arsye, Bashkia nuk ka kompetencë për të ndërhyrë drejtpërdrejt në segmentet e rrugëve kombëtare, por mund të përcjellë kërkesa dhe rekomandime pranë institucionit përgjegjës.

**Z. Dino Selimi:** Nuk është çështje se kujt i takon përgjegjësia, qoftë Autoriteti Rrugor Shqiptar apo Bashkisë. E rëndësishme është që të bashkëpunohet dhe, nëse është e nevojshme, të lidhen marrëveshje bashkëpunimi për zgjidhjen e problematikës.

**Znj. Julinda Karteri:** Është e rëndësishme të ndajme përgjegjësitë institucionale. Nga ana e Bashkisë nuk do të mungojë bashkëpunimi.

**Z. Vladimir Bakiaj:** Në lidhje me transparencën dhe organizimin e dëgjësive publike, mendoj se duhet të punohet për rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në këto procese.

**Znj. Julinda Karteri:** Jemi të vetëdijshëm se numri i banorëve në Bashkinë Tepelenë është në rënie, ndaj është e nevojshme të gjejmë forma të reja komunikimi për të qenë sa më pranë qytetarëve. Një nga këto forma është trasmetimi i mbledhjeve online.

Gjithashtu, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak publikojnë në mënyrë të vazhdueshme informacionin përkatës në faqet e tyre zyrtare, duke synuar rritjen e transparencës dhe informimin e qytetarëve. Qëllimi ynë është të gjejmë mënyra sa më efektive për të forcuar komunikimin dhe përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

**Z. Miftar:** Sa %e fondit kullosor mbetet ende pa plan mbarështimi?

Cilat janë objektivat kryesore të Bashkisë për vitin 2026 në drejtim të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave?

**Z. Avni Abedini:** Kjo është një çështje problematike që haset jo vetëm në Bashkinë Tepelenë, por edhe në nivel kombëtar. Deri më tani është hartuar plani i menaxhimit për një sipërfaqe prej 2,535 ha në zonën e Kurveleshit, e cila përfaqëson rreth 9% të sipërfaqes totale të fondit pyjor dhe kullosor të Bashkisë. Për vitin 2026 është planifikuar hartimi i planit të mbarështimit për ekonominë kullosore të Kurveleshit. Dokumentacioni teknik është përgatitur nga zyra përkatëse dhe i është përcjellë Drejtorisë së Financës për parashikimin e fondeve. Synimi është që, me financimin nga buxheti i Bashkisë, mbulimi me plane mbarështimi të rritet nga 0% në rreth 28% të sipërfaqes totale. Sa i përket objektiveve për këtë vit, janë përgatitur preventivat dhe janë planifikuar ndërhyrje për pastrimin dhe mirëmbajtjen e lerave, bazuar në nevojat e identifikuara në terren. Gjatë vitit të kaluar u realizuan ndërhyrje në katër lera, ndërsa edhe për këtë vit janë planifikuar investime të mëtejshme në këtë drejtim.

**Z. Dino Selimi:** Ka raste kur tokat e dhëna me qira nuk shfrytëzohen nga qiramarrësit, por u kalohen në përdorim personave të tjerë. Mendoj se bashkia duhet të marrë masa për të monitoruar dhe parandaluar këto raste.

**Z. Albert Kasi:** Materialet që lidhen me dhënien me qira të pasurive të Bashkisë paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak, përpara se administrata të vijojë me procedurat e dhënies me qira. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Këshilli Bashkiak ka detyrimin të zhvillojë dëgjesa publike në rastet e parashikuara nga ligji.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni:** Gjatë këtij mandati katërvjeçar, sa herë janë paraqitur raste për dhënien me qira të pasurive që kërkojnë konsultim publik, janë zhvilluar dëgjesa publike. Sa i përket kullotave që Bashkia jep me qira me kontrata njëvjeçare, Këshilli Bashkiak ka miratuar procedurën për dhënien e tyre me qira dhe këto kontrata lidhen nga administrata në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Znj. Matilda Çela:** Kur miratuam planin përkatës, përcaktuam që në zonat ku evidentohen konflikte ose problematika lidhur me dhënien në përdorim të tokave, Këshilli Bashkiak të organizojë dëgjesa publike përpara marrjes së vendimit.

**Z. Gëzim:** Kullotat jepen në përdorim për kullotje në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi, të cilat përcaktojnë procedurat dhe kriteret për dhënien e tyre me qira. bashkia ka miratuar planin operacional për administrimin e pasurive që mund të jepen me qira. Për kullotat verore dhe dimërore, kërkesat paraqiten brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni. Për vitin aktual është paraqitur vetëm një kërkesë. Kërkesat depozitohen pranë Bashkisë ose njësive administrative dhe shqyrtohen nga grupi i punës në bashkëpunim me administratorët e njësive administrative, mbi bazën e dokumentacionit të rregullt. Në rastin konkret, ekziston edhe një vendim gjykate që njeh të drejtën e pronësisë për kullotën. Deri në këtë moment, kjo është e vetmja kërkesë e paraqitur, lidhur me pretendimet se kullotat e marra me qira nga bashkia u jepen më pas në përdorim personave të tjerë, deri më tani nuk kemi pasur sinjalizime zyrtare nga kryetarët e fshatrave apo administratorët e njësive administrative.

**Z. Dino Selimi:** Ka shumë ankesa nga qytetarët në lidhje me projektin e kalasë. A keni informacion mbi ecurinë e këtij projekti? A janë përfshirë të gjitha banesat në projekt? Gjithashtu, ka pretendime se po ndërtohen kate shtesë në disa objekte dhe kërkohet sqarim nëse këto ndërtime janë të pajisura me lejet përkatëse.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni:** Kjo çështje nuk është pjesë e rendit të ditës së mbledhjes së sotme, prandaj nuk mund të trajtohet në këtë moment.

**Znj. Julinda Karteri:** Projekti për rjetezimin e Kalasë, i mbështetur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, zbatohet në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi me Bashkinë Tepelenë, në të

cilën janë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. Fondi Shqiptar i Zhvillimit është institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe për ndjekjen e zbatimit të projektit. Në përmbushje të detyrimeve ndaj qytetarëve, pas miratimit të projektit Bashkia hapi një periudhë njëmuore për administrimin e ankesave dhe shqetësimeve të banorëve të zonës së Kalasë. Gjatë kësaj periudhe u pritën të gjitha shqetësimet e paraqitura nga familjet. Për secilën familje kemi mbajtur shenimet shqetësimeve të tyre dhe kemi vene ne dispozicion Fondi Shqiptar i Zhvillimit për shqyrtim. Bashkia Tepelenë ka qenë vazhdimisht e përfshirë në proces përmes grupeve të punës dhe takimeve të zhvilluara me përfaqësuesit e Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me qëllim trajtimin e shqetësimeve të ngritura nga qytetarët, veçanërisht për banesat e prekura nga projekti. Gjithashtu, Bashkia Tepelenë i është drejtuar Instituti i Ndërtimit, duke kërkuar kryerjen e ekspertizës teknike për disa banesa, me qëllim vlerësimin e gjendjes së tyre dhe përcaktimin nëse ato përmbushin kushtet e nevojshme të qëndrueshmërisë. Aktualisht, Bashkia është në korrespondencë me institucionin për këtë çështje.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** A ka pyetje ose diskutime të tjera?

**Znj. Mirela:** Si përdoren fondet e programit për arsimin parashkollor dhe cilat janë prioritetet kryesore të Bashkisë në këtë sektor? Cilat investime dhe ndërhyrje mirëmbajtjeje janë realizuar nga Bashkia në kopshtet e saj gjatë vitit 2025?

**Znj. Julinda Karteri:** Fondet e programit të arsimit parashkollor përdoren për krijimin e kushteve sa më të mira për edukimin, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Këto fonde mbulojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve, furnizimin me energji elektrike, ngrohjen, furnizimin me ujë dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin normal të institucioneve të arsimit parashkollor. Prioritet i Bashkisë gjatë vitit 2025 ka qenë përmirësimi i kushteve të qëndrimit për fëmijët, veçanërisht në periudhën e dimrit, përmes ndërhyrjeve për sistemet e ngrohjes dhe mirëmbajtjen e godinave. Gjatë vitit 2025 është realizuar një donacion në lidhje me përmirësimin e eficiencës energjetike, ku është ndërhyrë me sistem kapot për përmirësimin e izolimit të godinës. Gjithashtu, gjatë këtij viti është lidhur një marrëveshje me kompaninë Shell, e cila do të investojë në instalimin e sistemit diellor në Kopshtin "Murat Kociu", duke përmirësuar sistemin e furnizimit me energji. Bashkia ka vijuar gjithashtu me mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e aseteve të saj në institucionet arsimore në të gjithë territorin e saj, përfshirë edhe ndërhyrje në objektet arsimore në njësitë administrative.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** Pika e radhës e rendit të ditës: Informacion mbi problematikat dhe masat e marra nga Sektori i MZSH-së për parandalimin e zjarreve gjatë periudhës së nxehtë të verës

**Z. Xhevit Mana:** Relaton materialin shoqërues bashkëlidhur, duke paraqitur informacionin mbi situatën, problematikat e evidentuara dhe masat e marra nga Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të zjarreve gjatë sezonit veror.

**Kryetari i Këshillit Bashkiak:** Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës: Kërkesa dhe ankesa të qytetarëve.

**Albert Hyseni**, banor i fshatit Nivicë – Kërkesë për mbështetje financiare për rikonstruksionin e banesës. Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

**Adriatik Tola**, banor i qytetit Tepelenë – Kërkesë për mbështetje financiare për rikonstruksionin e pallatit të banimit. Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

**Dituri Elmazi**, banore e qytetit Tepelenë – Kërkesë për ndihmë financiare. Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

**Salihe Hysa**, banore e qytetit Tepelenë – Kërkesë për ndihmë financiare. Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

**Samuel Çuni** – Kërkesë për ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

**Fatime Memalla** – Kërkesë për ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

**Mynrye Rama banor fshati mamaj** Kerkese per ndihme rikonstruksion banese. Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

**Agron Hoxha:** Kërkesë për marrjen në mirëmbajtje dhe kthimin në muze të një objekti (ish-shkollë). Këtë kërkesë tja percjellim bashkisë zyra përkatëse

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, Kryetari i Këshillit Bashkiak deklaron mbylljen e mbledhjes.

Mbledhja përfundon në orën 11:51

**SEKRETARE E KËSHILLIT**

**Valbona ÇELA**



**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Arben GUMENI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCA E KËSHILLTARËVE  
MBLEDHJA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË  
Datë: 26.06.2026

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 26.06.2026 morën pjesë këshilltarët si më poshtë:

| Nr | Emër      | Mbiemër | Nënëshkrimi |
|----|-----------|---------|-------------|
| 1  | ARBEN     | GUMENI  |             |
| 2  | MATILDA   | ÇELA    |             |
| 3  | DINO      | DELIMI  |             |
| 4  | MIRELA    | VARFI   |             |
| 5  | MJAFTONI  | ZERAJ   |             |
| 6  | ESMERALDA | BISHANI |             |
|    | BESNIK    | MAÇA    |             |
| 8  | LATIF     | KAÇAJ   |             |
| 9  | MIFTAR    | META    |             |
| 10 | ILIR      | HASKA   |             |
| 11 | MARSELA   | BALILI  |             |
| 12 | MARIOS    | JORGO   |             |
| 13 | DITAR     | HODAJ   |             |
| 14 | VLADIMIR  | BAKIAJ  |             |
| 15 | VLADIMIR  | GJONÇA  |             |